



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS ZUBIN POTOKUT

Numri i lëndës: 2021:057423

Datë: 30.08.2024

Numri i dokumentit: 06105830

P.nr.56/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA ZUBIN POTOK, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona LAJQI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.H., për shkak të veprës penale Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.2 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.99/2021 të datës 18.10.2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datë 31.07.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, i pandehuri A.H., mbrojtësi i tij sipas autorizimit, Av.A.D., me datë 01.08.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.H., nga i ati M....., e ëma H....., e vajzerise Pe....., i lindur me, në fshatin Ç....., Komuna e Z... P....., ku edhe tani jeton, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, pensionit, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor të vitit 2018, në Z... P....., në cilësinë e zëvendës Kryetarit të komunës së Z....P.....nuk ka deklaruar në formularin e deklarimit të pasurisë së tij, ashtu që i

pandehuri ka gene i detyruar qe ne A.... k... K..... te bej deklarimin e pasurisë, te ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga data 01 e deri me date 31 Mars te vitit 2019, dhe nuk ka paraqitur saktë te dhënat e kërkuara për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor te vitit 2018, duke mos deklaruar sakte prejardhjen e pasurisë se deklaruar ne formularin e deklarimit te pasurisë,

-Me këtë ka kryer veprën penale: Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.2 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 42, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70, e lidhur me nenin 430 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, 452 dhe 462 të KPP-së, dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/II.Nr.99/2021 e datës 02.07.2024, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej 1300 euro (*me fjalë: njëmijë e treqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.
- II. DËNIM ME BURGIM ME KUSHT në kohëzgjatje prej tetë (8) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën e verifikimit prej tetëmbëdhjetë (18) muajve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- III. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim
- IV. E dëmtuara, A... K...K.... me seli në rrugën “....” në P..., për kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.99/2021 të datës 02.07.2024 kundër të pandehurit A.H., për shkak të veprës penale Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.2 dhe 1 të KPRK-së.

Prokuroria, me datë 02.07.2024 i ka dërguar gjykatës njoftimin për arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, e lidhur në mes të Prokurorisë, të pandehurit A.H. dhe mbrojtësit të tij av. A.D., sipas autorizimit si dhe marrëveshjen e arritur me datën 02.07.2024.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare me datë 31.07.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Arjan Xhema, i pandehuri A.H., mbrojtësi i tij, Av.A.D..

Në kuptim të nenit 230 par. 17, të KPPRK-së, gjyqtarja e vetme gjykyuese e ka dëgjuar të pandehurin dhe ka vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën e veprës penale e cila i është vënë në barrë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se nuk ka qenë i detyruar apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të paraqitura në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për hedhje të akuzës që parashihet me nenin 248 par.1, të KPPRK-së.

Në kuptim të nenit 230 par.18 të KPPRK-së, gjyqtarja e vetme gjykyuese ka dëgjuar pikëpamjet të Prokurorit të Shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit së tij.

Prokurori i Shtetit në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë deklaroi se: mbetem në tërësi pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga ana e pandehurit e cila marrëveshje është arritur pas konsultimeve të mjaftueshme të tij me mbrojtësin e tij, duke i vënë në dijeni së pari veprat e kryera pastaj pasojat e veprave dhe dënueshmërinë e tyre.

Po ashtu i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë marrëveshjes së arritur për pranimin e fajësisë me Prokurorin e Shtetit.

Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, e konform nenit 230 të KPPRK-së, gjykata fillimisht ka përcaktuar se i pandehuri ka kuptuar natyrën e veprës penale, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të cilat paraqitën në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par. 1, të KPPRK-së.

Gjykata është bindur se janë plotësuar kushtet nga neni 230 par. 17, i KPPRK-së, respektivisht se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, çka e pohoi edhe vet i pandehuri dhe mbrojtësi i tij gjatë seancës, së pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, dhe se nuk ka qenë i shtrënguar apo i detyruar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, gjë që po ashtu është pohuar nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, tutje gjykata gjeti së ky pranim i fajësisë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: memorandum zyrtar i datës, informate nga A...-ja e datës, kërkesa e A...-se për sqarim lidhur me deklarimin e pasurisë e datës ..., Njoftim drejtuar A.... kundër K.... e datës, regjistër për deklarimit e pasurisë nga i pandehuri A.H. i datës ..., formular për deklarimin e pasurisë i datës ..., Informata e A...-se për sqarim lidhur me deklarimin e rrem të pasurisë e datës ... dhe datës ..., Certifikatat nga A... K... e K... e datës ..., kërkesa e A..drejtuar A.. ka.. të K... e dt., përgjigjja e A... K... – certifikatat për njësit kadastrale ..., ..., ..., .., dhe ... në zonën kadastrale në Q... të datës ..., Përgjigjen e O.. së N..e lidhur me kontratat e shitblerjeve të pasurive-pronave të paluajtshme, Formulari i deklarimit te pasurisë i te pandehurit A.H. i datës ..., deklarata e të pandehurit A.H. e dhënë në hetuesi me datë ..., deklaratat e dëshmitarëve të dhëna ne hetuesi si dhe shkresa tjera te lendes.

Andaj, gjykata konform nenit 230 par. 20, të KPPRK-së, ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me marrëveshjen, dhe ka urdhëruar që kjo marrëveshje të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë.

Prokurorja e Shtetit lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese deklaroi së: propozoj që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë si dhe fakti së është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese, të njëjtat ja lë në vlerësim gjykatës.

Mbrojtësi i të pandehurit sa i përket rrethanave lehtësuese dhe rënduese është deklaruar: ekzistojnë një mori rrethanash lehtësuese nga ana e të pandehurit, nuk ka qenë asnjëherë i gjykuar më parë, nuk zhvillohet asnjë procedurë tjetër penale, pendimin dhe ka kërkuara nga gjykata se me dënimin e propozuar në marrëveshje e cila është aprovuar nga gjykata do të arrihet qëllimi i dënimit

I pandehuri A.H., lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese deklaroi së: qëndroj në tërësi pranë marrëveshjes dhe kërkoj që të me shqiptohet dënimi si në marrëveshjen, në kuadër të marrëveshjes për veprën penale për të cilat ngarkohem, e mbështes fjalën e mbrojtësit është hera ime e parë që gjendem në gjykate skam qen i dënuar më parë.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese: sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, i njëjti ka pohuar se ndjen keqardhje për veprën e kryer, pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqipton dënim me gjobë dhe me si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, e pas parasysh edhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe në kuptim të nenit 40 par. 1 pika 1.3, nenit 43, 46 dhe nenit 430 par.2 dhe 1 të KPRK-së gjykata të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë si në piken I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon, refuzon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPK-së. Vendimi lidhur me Taksën për Programin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, është marrë konform nenit 36 par. 3, pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit – 08/L-109.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 462 të KPP-së ashtu që të dëmtuarit i ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364, 450 dhe 462 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA ZUBIN POTOK

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.56/2022, datë 30.08.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Marigona LAJQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.